

ikubINFO shpk
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 17

ikubINFO shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	80,887,870	24,104,509
Llogari të arkëtueshme	5	32,987,519	37,268,962
Inventari	6	1,800,000	1,800,000
Aktive të tjera afatshkurtra	7	898,119	2,096,794
Total Aktiveve Afatshkurtra		116,573,508	65,270,265
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	8	8,143,957	6,678,620
Total aktive afatgjatë		8,143,957	6,678,620
Total Aktive		124,717,465	71,948,885
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregëtare	9	16,809,510	15,046,259
Llogari të pagueshme të tjera	10	62,723,420	8,009,826
Total Detyrime afatshkurtra		79,532,930	23,056,085
Detyrime afatgjatë			
Totali i detyrimeve		79,532,930	23,056,085
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	11	4,200,000	4,200,000
Fitimi i ushtrimit		40,984,535	44,692,800
Total kapitali aksionar		45,184,535	48,892,800
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		124,717,465	71,948,885

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Te ardhura	12	314,705,293	243,850,666
Materiale te para dhe te konsumueshme	13	(66,138,136)	(37,738,496)
Shpenzime personeli	14	(181,049,684)	(135,734,841)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	15	(1,958,725)	(1,921,529)
Shpenzime te tjera	16	(17,311,205)	(18,506,149)
Fitimi operativ		48,247,543	49,949,652
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	17	148,371	(102,461)
Total shpenzime financiare		148,371	(102,461)
Fitimi para tatimit		48,395,914	49,847,191
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	(7,411,379)	(5,154,392)
Fitimi i vitit		40,984,535	44,692,800

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


ikubINFO shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Fitime të mbartura /humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	200,000		32,191,121	32,391,121
Rritje Kapitali	4,000,000		(4,000,000)	-
Fitimi i vitit			44,692,800	44,692,800
Dividendë të paguar			(28,191,121)	(28,191,121)
31 Dhjetor 2013	4,200,000	-	44,692,800	48,892,800
Fitimi i vitit			40,984,535	40,984,535
Dividendë të paguar			(44,692,800)	(44,692,800)
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				-
31 Dhjetor 2014	4,200,000	-	40,984,535	45,184,535

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i shoqërisë IkubINFO sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 20 Mars 2015 nga:


Romeo Sherko
 Administrator




Ana QOSE
 Hartuesi i Pasqyrave Financiare

ikubINFO shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Paasqyra e Fluksit të Parasë
Më 31 Dhjetor 2014

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	48,395,914	49,847,191
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	1,958,725	1,921,529
Shpenzime për interesa	(12,886)	(9,597)
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	50,341,753	51,759,123
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në llogari të arketueshme dhe të tjera	4,404,009	(7,749,656)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	56,476,844	(34,141,346)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	111,222,606	9,868,121
Interesa të paguara	12,886	9,597
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(6,335,269)	(2,109,633)
	(6,322,383)	(2,100,036)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata material	(3,424,062)	(1,278,852)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(3,424,062)	(1,278,852)
Aktivitetet financuese		
Dividendë paguar	(44,692,800)	(28,191,121)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(44,692,800)	(28,191,121)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	56,783,361	(21,701,888)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	24,104,509	45,806,397
Mjetet monetare në fund të periudhës	80,887,870	24,104,509

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "ikubINFO" Shpk është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë regjistrave të Qendres Kombëtare të regjistrimeve me datë 12.05.2011. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 4,200,000 leke i zotëruar nga si me poshtë:

- Investment SHERKO - ikub GROUP 41.5%
- Armand Shara 28%
- Elton Ropi 15%
- Albano Qojle 15.5%

Administrator i shoqërisë është Z.Romeo Sherko.

Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë. Ajo është e regjistruar në Degen e Tatimeve, Tiranë me NIPT L11712002T.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është " I. Aktiviteti i zhvillimit të software aplikative. 1.1 Në platforma Net. Java, Web Assembler.1.2 Në fushën e Taksave, Content Management, Portale, Interoperabilitet, e të tjera të përafërta. Aktiviteti i shërbimeve mbi software aplikative të zhvilluara nga vetë Shoqëria ikubInfoSoft, ose software të tjera ku ka kompetencë.3. Aktiviteti i implementimit të sistemeve Database, Middleware, BI, Data Warehouse dhe platformave që shërbejnë për zhvillime aplikacionesh, objekt i veprimtarisë së ikubInfoSoft shpk. 4.Trajnime për çdo specialitet që lidhet me aktivitetet e ikubInfoSoft shpk. 5. Aktiviteti i konsulentëve në fushën e software aplikative. 6. Aktiviteti i Solution Design për software aplikative. 7. Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve me komponente që bëjnë pjesë në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6. 8. Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve me objekt ICT. 9. Aktiviteti i shitjes së produkteve dhe shërbimeve që ka në objektin e veprimtarisë. 10. Aktiviteti i shitjes së pajisjeve ICT. II.Aktiviteti i shitjes së licencave software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to. 12. Software si shërbim. 13. Aktivitet në shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së softwareve. 14. Aktivitet në shërbime të përpunimit të të dhënave. 15. Aktivitet në shërbime të hostimit të bazave të të dhënave dhe të të dhënave përkatëse. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ikubInfoSoft sh.p.k zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. ".

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte 36 punonjës (2013: 35 punonjës).

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

(Vlerat janë në Lek)

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbriturhumbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Te tjera	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Mjete monetare në banke	80,691,187	24,017,609
Mjete monetare në arke	196,683	86,900
	<u>80,887,870</u>	<u>24,104,509</u>

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kliente	32,987,519	37,268,962
	<u>32,987,519</u>	<u>37,268,962</u>

6. INVENTARI

Gjendjet e Inventarit me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë :

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Licenca për Oracle Database St Edition - për maturën shtetërore	1,800,000	1,800,000
	<u>1,800,000</u>	<u>1,800,000</u>

7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Sigurime Shoqërore perfitime	30,046	136,611
Tatimi Mbi Fitimin	868,073	1,944,183
Kerkesa te tjera te arketueshme	-	16,000
	898,119	2,096,794

8. AKTIVE AFATGJATA

	Mobilje dhe orendi	Kompjuterë	Të tjera	Totali
Kosto				-
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	618,975	6,980,964	1,692,326	9,292,264
Shtesa	0	1,197,075	81,777	1,278,852
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	618,975	8,178,039	1,774,103	10,571,116
Shtesa	1,052,500	2,228,209	143,353	3,424,062
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	1,671,475	10,406,248	1,917,455	13,995,178
Zhvlerësimi i akumuluar				
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	116,860	1,446,159	407,949	1,970,968
Amortizimi i vitit	100,686	1,563,243	257,599	1,921,528
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	217,546	3,009,402	665,548	3,892,496
Amortizimi i vitit	134,717	1,600,489	223,519	1,958,725
Nxjerrje jashtë përdorimit				0
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	352,263	4,609,891	889,067	5,851,221
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	502,115	5,534,805	1,284,377	7,321,296
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	401,429	5,168,637	1,108,555	6,678,620
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	1,319,212	5,796,357	1,028,388	8,143,957

9. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Detyrime ndaj Furnitoreve për Fatura të pranuar	15,331,848	15,046,259
Detyrime ndaj Furnitoreve për Fatura të pambërritura	1,477,662	
	<u>16,809,510</u>	<u>15,046,259</u>

10. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Detyrimet të tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga për t'u paguar	43,934,603	70,049
Detyrime për sigurime shoqërore & shëndetësore	1,001,534	742,779
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	14,423,980	4,492,299
TVSH për t'u paguar	3,293,173	2,704,699
Detyrime të tjera	70,130	
	<u>62,723,420</u>	<u>8,009,826</u>

11. KAPITALI AKSIONAR**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 4,200,000 Leke.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 40,984,535 leke përfaqëson fitimin e vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

12. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga kryerja e shërbimeve	314,705,293	243,850,666
	<u>314,705,293</u>	<u>243,850,666</u>

Rakordimi i te ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	<u>Dhjetor 2014</u>
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	319,409,572
Autofatura	<u>(4,704,279)</u>
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	<u>314,705,293</u>
Shitje shërbime	<u>314,705,293</u>
Te ardhura të deklaruara në Pash që janë deklaruar shitje në FDP	<u>314,705,293</u>
Te ardhurat nga interesat	12,886
Fitim nga kembimet valutore	<u>1,266,857</u>
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Fitimit	<u>315,985,036</u>

13. LENDET E PARA DHE SHËRBIMET

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe ato të mbyllur më 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Sherbime programimi	26,953,793	18,082,961
Sherbime mirembajtje	23,766,510	19,655,535
Licenca	<u>15,417,833</u>	-
	<u>66,138,136</u>	<u>37,738,496</u>

14. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime për paga	117,756,708	130,612,840
Shpenzime për personelin	55,989,516	
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndet	<u>7,303,460</u>	<u>5,122,001</u>
	<u>181,049,684</u>	<u>135,734,841</u>

15. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e amortizimit për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime amortizimi	1,958,725	1,921,529
	<u>1,958,725</u>	<u>1,921,529</u>

16. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe atë të mbyllur me 31 Dhjetor 2013 janë të analizuar si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Blerje energji	340,151	345,005
Shpenzime komunikimi	815,542	824,777
Reklama, publicitet	637,793	3,317,948
Konsulencë juridike, financiare	802,640	240,000
Shpenzime sigurim/noterizim/perkthim	3,567,525	168,657
Taksa vendore	25,120	25,120
Mirembajtje ambiente, pajisje	767,323	1,353,608
Qira zyre	4,821,041	4,758,713
Udhetime dhe dieta	1,633,963	4,038,694
Shpenzime kancelarie e të ngjashme	127,367	153,219
Komisione bankare	754,501	1,282,926
Gjoha dhe penalitete	1,243	-
Te tjera	3,016,996	1,997,482
	<u>17,311,205</u>	<u>18,506,149</u>

17. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë analizuar si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga interesat	12,886	9,597
Humbje nga kembimet valutote	(1,131,372)	(706,128)
Te ardhura nga kembimet valutore	1,266,857	594,070
	<u>148,371</u>	<u>(102,461)</u>

18. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	48,395,914	49,847,191
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	1,013,278	1,696,726
Shpenzime pritje & percjellje	11,940	542,201
Shpenzime udhetimi	159,902	-
Penalitet, gjoba e demshperblime	1,243	-
Shpenzime te tjera	840,193	1,154,525
Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)	49,409,192	51,543,917
Humbje fiskale e mbartur	49,409,192	51,543,917
Tatim fitimi @15%	7,411,379	5,154,392
	40,984,535	44,692,800
	31 Dhjetor 2014 ne Lek	31 Dhjetor 2013 ne Lek
Tatimi Mbi Fitimin I parapaguar me 1 janar	1,944,183	4,988,942
Tatim Fitimi I Parapaguar 2014/2013	6,335,269	2,109,633
Tatim Fitimi 2014/2013	(7,411,379)	(5,154,392)
Tatim Fitimi I mbipaguar	868,073	1,944,183

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014	%	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013	%
Fitimi per vitin	48,395,914	100.00%	49,847,191	100.00%
Tatim fitimi me normen e aplikueshme	7,259,387	15.00%	4,984,719	10.00%
<i>Rregullime per diferenca te perhershme:</i>				
Shpenzime pritje & percjellje	1,791	0.00%	54,220	1.09%
Shpenzime udhetimi	23,986	0.05%	-	0.00%
Penalitet, gjoba e demshperblime	186	0.00%	-	0.00%
Shpenzime te tjera	126,029	0.26%	115,453	2.32%
Totali	7,411,379	15.31%	5,154,392	10.34%

19. Palet e lidhura

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë të detajuara si më poshtë:

Te pagueshme tregtare

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te pagueshme ndaj paleve te lidhura		
ikubINFO Software Solutions	181,582	6,120,000
ikub.al	1,761,689	3,000,080
Totali	1,943,271	9,120,080

Blerje nga palet e lidhura

	2014	2013
ikubINFO Software Solutions	11,793,983	6,374,288
ikub.al	666,433	3,354,351
Totali	12,460,416	9,728,639

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

20. ANGAZHIME DHE PASIGURI*Çeshtje gjyqesore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

21. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Tirane me, 30 Mars 2015

VERTETIM


Me ane te kesaj shkrese vertetojme se MAZARS sh.p.k eshte angazhuar per te kryer auditimin e pasqyrave financiare te shoqerise **ikub INFO Shpk** me NIPT L11712002T dhe seli te regjistruar ne adresen: Rr"Murat Toptani", "Gjergji Center", kati VII , Tirane, per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2014.

Ne nuk e kemi perfunduar ende procesin e auditimit dhe ne kete moment nuk jemi ne gjendje te leshojme raportin e auditimit.

E leshojme kete vertetim, sipas kerkeses se shoqerise **ikub INFO Shpk**.

MAZARS sh.p.k

Ekspert Kontabel i Regjistruar



Teft. Gjini  **MAZARS**

Rr. Emin Duraku, Pali "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al